

MARREVESHJE DHE RAPORT NE LIDHJE ME BASHKIMIN ME PERTHITHJE

DRAFT 22.08.2018

NDERMJET

NCI Shpk.

(si shoqëria përthithëse)

Dhe

ENERGIA PULITA Shpk.

(si shoqëria e përthithur)




TABELA E PERMBAJTJES

I. HYRJE.....	2
II. BASHKIMI ME PERTHITHJE	3
III. BILANCI I HAPJES DHE I MBYLLJES	3
IV. AKTIVET E TRANSFERUARA.....	3
V. MBYLLJA	4
VI. KUOTAT	4
VII. SHOQERIA, PERPARESITE E VECANTA DHE PERFITIMET	4
VIII. MBROJTJA E KREDITOREVE	4
IX. TE NDRYSHME	4
X. PASOJAT PER TE PUNESUARIT	5
XI. ZGJIDHJA E MARREVESHJES.....	5
XII. LIGJI I ZBATUESHEM.....	5
Tirane, me 22.08.2018	5



I. HYRJE

Shoqëria NCI Shpk, është shoqëri e themeluar dhe organizuar ne përputhje me legjislacionin shqiptar me numër unik te identifikimit te subjektit (NUIS) L41709011G, me seli ne adresën: Rruga Akacia, Zona Kadastrale 2704, Nr. Pasurie 465/27, Farke MJULL BATHORE, Tirane, Shqipëri, e cila ka objekt veprimtarie si vijon:

- Tregtim me shumice e pakice, import eksport ne tërësi te mallrave industriale, ushqimore, pije alkoolikë e freskuese, e pajisjeve teknologjike, pajisjeve elektronike, elektrike, material ndërtimi, hidrosanitare. Tregtim i pajisjeve dhe artikujve mjekësore, produkteve farmaceutike dhe sistemeve përkatës te menaxhimit qe lidhen me to, padisje për laboratorë, produkte kimike dhe shërbimeve qe lejohen nga legjislacioni shqiptar ne fuqi. Tregtim gazi teknik, terapeutik, farmaceutik dhe gazrave te tjerë ne përgjithësi. Projektimin realizimin dhe instalimin e impianteve te lidhura me gazin përfshire këtu dhe projektimin, realizimin e instalimin e impianteve elektrike te domosdoshme për funksionimin e tyre. Ndërtime civile, impiante hidraulike, mekanike dhe elektrike për strukturat spitalore, ndërtime ujësjellësish dhe kanalizimesh, rikonstruktim i ndërtesave civile dhe spitalore, gërmime, sistemime, mbushje te terreneve, centrale hidroelektrike. Te merret me projektimin, realizimin e HEC-eve si dhe shfrytëzimin e tyre. hapjen e bareve dhe restoranteve, pikave te autoservisit, lavazhit, pjese këmbimi, hotele, fshatrave turistike si dhe agjencive për shitblerje, dhënie me qira te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, agjencive komisionarë, transport te udhëtareve e te mallrave si brenda vendit dhe jashtë tij dhe çdo lloj aktiviteti te lejuar nga ligji, etj. Te leshoje garanci te çdo lloji ne favor te te treteve, per detyrime dhe borxhe te tyre, qofte dhe kur nuk janë ortake, te marre pjese apo te likujdoje pjesëmarrjen drejtepersedrejti ose indirekt, ne shoqëri te tjera te formuara ose qe jane duke u formuar ne Shqiperi apo jashte saj me objekt aktivitet te ngjashëm apo te lidhur me te sajën, si dhe te realizoje koordinimin teknik, organizativ e financiar te shoqërive te tjera. Ushtrimin e aktivitetit privat ne fushën e profesionit te avokatisë, kontabël i miratuar, mbajtje bilanci te shoqërive private, kontabilitete, ne fushën e përkthimeve, rikuperim borxhesh, noteri etj. Aktivitete ne fushën e konsulences financiare, ligjore, inxhinierike, noteriale.

Kapitali themeltar i shoqërisë ka vlerën e 100.000,00 leke.

Ortak i vetëm i NCI Shpk. është Z. Besnik Halili zotërues i 100% te kapitalit themeltar te shoqërisë.

ENERGIA PULITA Shpk, një shoqëri e themeluar dhe organizuar ne përputhje me legjislacionin shqiptar, me numër unik identifikimi te subjektit (NUIS): K72117502R, me seli ne adresën: Lagjia Nr. 4, Rruga Dëshmoret, Pallati Nr. 845, Durrës, Shqipëri e cila ka objekt veprimtarie: Shoqëria ka për objekt, "financimin, projektimin, ndërtimin, vënien ne pune, administrimin dhe mirëmbajtjen e HEC-eve "Gostivisht", "Langarica 3", "Ura e Dashit" mbi lumin Gostivisht dhe Langarice, Përmet, si dhe prodhimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi, shitja dhe tregtimi i energjisë elektrike te prodhuar.

Kapitali themeltar i shoqërisë ka vlerën e 70.100.000,00 leke.

Ortak i vetëm i ENERGIA PULITA Shpk. është **NCI Shpk**, një shoqëri e themeluar dhe organizuar ne përputhje me legjislacionin shqiptar me numër unik te identifikimit te subjektit (NUIS) L41709011G, me seli ne adresën: Rruga Akacia, Zona Kadastrale 2704, Nr. Pasurie

465/27, Farke MJULL BATHORE, Tirane, Shqipëri zotëruese e 100% te kapitalit themeltar te shoqërisë.

Shoqëria Energjia Pulita ShPK. bashkohet nga ana ligjore dhe organizative me shoqërinë NCI Shpk. Ne ketë mënyre NCI Shpk. dhe ENERGIA PULITA Shpk. integrohen ne një person juridik te vetëm (“**Transaksioni i Bashkimit**”), ku NCI Shpk. është shoqëria përthithëse dhe ENERGIA PULITA Shpk., ajo e përthithur.

Qëllimi i Bashkimit është përqendrimi i forcave dhe mjeteve për realizimin e objektit te ENERGIA PULITA Shpk ne funksion te rritjes se aktivitetit dhe fitimit.

II. BASHKIMI ME PERTHITHJE

Ne ketë operacion bashkimi shoqëria NCI Shpk. do te jete shoqëria përthithëse e shënuar ne vijim si shoqëria përfituese e kontributeve, kurse shoqëria ENERGIA PULITA Shpk. do te jete shoqëria e përthithur.

Ne kuadrin e këtij procesi, sikurse bazuar ne Nenin 215, paragrafi 1 te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar (“Ligji 9901”), shoqëria ENERGIA PULITA Shpk. do te transferoje me ane te Bashkimit me Përthithje te gjitha aktivet dhe pasivet qe zotëron sipas dokumentacionit financiar te deritanishëm.

Ne përputhje me Nenin 220, paragrafi 2, pika c, te Ligjit “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, shoqëria e përthithur ENERGIA PULITA Shpk. do te vlerësohet e prishur dhe shoqëria përthithëse NCI Shpk. do te vazhdoje te ekzistojë.

III. BILANCI

Përthithja do te kryhet ne datën e regjistrimit te Mbylljes se Bashkimit me Përthithje ne Regjistrin Tregtar (“**Regjistri Tregtar**”) pranë Qendrës Kombëtare te Biznesit,.

Bashkimi me përthithje bazohet ne bilancet e NCI Shpk. dhe ENERGIA PULITA Shpk. me date 09.07.2018 (“Bilancet e Hapjes”).

Ne aspektin e kontabilitetit, te dyja shoqëritë do te vazhdojnë te regjistrojnë te gjitha operacionet e veprimtarisë te kryera prej tyre deri ne datën e realizimit te bashkimit te kontabilizuara veç e veç.

Bilancet e Hapjes se Bashkimit me Përthithje do t’i bashkëngjitet kësaj Marrëveshje te Bashkimit me Përthithje.

IV. AKTIVET E TRANSFERUARA

Ne përputhje me Nenin 215, paragrafi 1 te Ligjit 9901, ENERGIA PULITA Shpk. transferon si pasoje e Bashkimit me Përthithje, te gjitha aktivet e qëndrueshme materiale dhe jo materiale, te paraqitura ne formën e aktiveve dhe pasiveve, duke përfshire marrëdhëniet kontraktore dhe marrëdhënie te tjera juridike si dhe qëndrime ligjore te çdo lloji, te arkëtueshmet dhe detyrime, detyrime potenciale, te arkëtueshmet te ardhshme (“Aktivet dhe Pasivet e Transferuara”).

NCI Shpk. merr ne posedim te gjithë librat, korrespondencën, te dhënat operative dhe regjistrime te tjera te mbajtura nga ENERGIA PULITA Shpk. Gjithashtu NCI Shpk. merr ne posedim te gjitha

instrumentet e nevojshëm për të provuar ekzistencën e te drejtave që do të transferohen tek ai. NCI Shpk. do të ruajë të gjithë librat, korrespondencën, të dhënat operative dhe regjistrime të tjera tregtare për ENERGIA PULITA Shpk. gjatë gjithë periudhës ligjore të ruajtjes së tyre.

NCI Shpk. do të regjistrojë pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme çdo të drejtë pronësie (nëse ka) që transferohet nga ENERGIA PULITA Shpk. drejt NCI Shpk. si pasoje e Përthithjes, në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe me aktet nënligjore përkatëse.

V. MBYLLJA

Me qëllim Mbylljen, palët do të bëjnë të mundur që dokumentet e mëposhtëm të përgatiten, nënshkruhen dhe dorëzohen:

- i. Marrëveshjen Përfundimtare të Bashkimit me Përthithje;
- ii. Një kopje të Vendimit të Ortakeve të NCI Shpk. dhe ENERGIA PULITA Shpk. gjatë së cilës miratohen Marrëveshja Përfundimtare dhe përfundimi i Bashkimit me Përthithje.

VI. KUOTAT

Shoqëria NCI Shpk. do të jetë zotëruese e kapitalit të shoqërisë ENERGIA PULITA Shpk. në datën e realizimit përfundimtar të marrëveshjes, e cila do të përbehet nga 1 (një) kuote e vetme dhe pjesëmarrja në përqindje (%) 100 %.

Kapitali i shoqërisë pas bashkimit me përthithje do të jetë në vlerën totale të bashkimit të kapitalit të dy shoqërive, prej **70,200.000,00 Leke**.

VII. SHOQERIA, PERPARESITË E VECANTA DHE PERFITIMET

Ky operacion bashkimi nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçante.

VIII. MBROJTJA E KREDITOREVE

Kreditorët e NCI Shpk. dhe ENERGIA PULITA Shpk. mbrohen në përputhje me nenin 221 të Ligjit 9901 i ndryshuar.

IX. TË NDRYSHME

Kjo Marrëveshje (bashkë me dokumentet bashkangjitur saj) përben Marrëveshjen në tërësi dhe Marrëveshjen mes Palëve, zëvendëson dhe ka përparësi ndaj çdo Marrëveshje, rregullimi apo veprim të mëparshëm të Palëve në lidhje me këtë çështje.

Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshje do të jetë i vlefshëm vetëm nëse është bërë me shkrim dhe është nënshkruar nga Palët.

Në rast se një pjesë e kësaj Marrëveshjeje është /ose shpallet e pavlefshme ose jo detyruese, pjesa tjetër mbetet e vlefshme dhe detyruese për Palët. Në këtë rast, Palët zëvendësojnë dispozitat e pavlefshme ose jo detyruese me dispozita të vlefshme dhe detyruese, efekti i të cilave, për aq sa është e mundur, është sa më i afërt me dispozitat e pavlefshme ose jo detyruese duke pasur parasysh përmbajtjen dhe qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

X. PASOJAT PER TE PUNESUARIT

Duke marre parasysh se aktualisht ENERGIA PULITA Shpk. nuk ka asnjë punëmarrës atëherë nuk parashikohet asnjë pasoje mbi punëmarrësit e ENERGIA PULITA Shpk.

Duke marre parasysh se NCI Shpk., do te jete ne cilësinë e shoqërisë përthithëse nuk parashikohet asnjë pasoje mbi punëmarrësit e NCI Shpk.

XI. ZGJIDHJA E MARREVESHJES

Kjo marrëveshje mund te zgjidhet ne çdo kohe përpara Datës se Mbylljes me miratimin e dhëne me shkrim nga te dyja Palët.

XII. LIGJI I ZBATUESHEM

Kjo marrëveshje do rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve dhe akteve te tjerë me fuqinë e ligjit te zbatueshme ne Republikën e Shqipërisë dhe veçanërisht nga nenet 215-226, te ligjit nr. 9901 "Për Tregtaret dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, date 14.04.2008 dhe Ligji nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Biznesit" i ndryshuar.

Tirane, me 22.08.2018

Shoqëria NCI Shpk.


Administratori

Shoqëria ENERGIA PULITA Shpk.

Administratori



[Handwritten signature]



[Handwritten signature]